

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
NDERMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE,BASHKIA KORÇE

Date 26.03.2019

Për: *Shqerite, BOE “SIMAKU SHPK” SH.P.K, DHE “VASHTEMI” , me NIPT K43721001Q dhe NIPT J64103054Q adresat perkatesisht : Korce Libonik SYMIZ Km. i 13, Rruga Korçe-Tirane, zona kadastrale 3553, nr.pasurie 723/10 dhe Korce Libonik VASHTEMI Rruga Nacionale KorcePogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6.*

Procedura e prokurimit: **“Asfalto-beton dhe bitum per sperkatje”**

Numri i referencës së procedurës/loti : **REF-07284-02-11-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***Kjo kontrate ka per qellim realizimin e furnizimit me asfalt-beton dhe bitum.***

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

- 1. Shoqeria “BI-SERVIS” SH.P.K, NIPT K41614010T me vleren:**
19,124,000 (nentembedhjet milion e njeqind e njezet e kater mije)leke.
- 2. Shoqeria “SARK” SH.P.K, NIPT K52531415H me vleren:**
19,300,000 (nentembedhjet milione e treqind mije)leke.
- 3. Shoqeria “S I R E T A 2F” SH.P.K, NIPT K51501008J me vleren:**
21,110,000 (njezet e nje milion e njeqind e dhjete mije)leke.
- 4. Shoqeria BOE “SIMAKU SHPK” SH.P.K, NIPT K43721001Q DHE “VASHTEMI” , NIPT J64103054Q me vleren:**
21,825,000 (njezet e nje milion e teteqind e njezet e pese mije)leke.
- 5. Shoqeria “RESULI - ER” SH.A, NIPT L12510413V me vleren:**
Nuk ka paraqitur oferte.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria “BI-SERVIS” SH.P.K, per arsye se:

1.Operatori nuk vërteton realizimin e furnizimeve te ngjashme sipas kriterëve te vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik pika 1 e dokumenteve te tenderit ne te cilin kerkohen:

Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit .

Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Operatori juaj ka paraqitur kontraten nr. 2686 prot. Te dates 10.08.2018 te lidhur me Bashkine Divjake me objekt: ” Blerje binderi per asfaltimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake” me vlere 10,352,100 leke me tvsh dhe 8,626,750 pa tvsh. Vlora e kesaj kontrate eshte me e vogel se 40% e fondit limit i cili perlllogaritet te jete ne vleren 9,000,000.

2. Operatori juaj nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e detyrimeve te maturuara te energjise elektrike per muajin janar 2019 te cilat duhet te ishin shlyer brenda muajit shkurt 2019.

2. Shoqeria “SARK” SH.P.K, per arsye se:

Per automjetin e transportit kamion te kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit te dokumenteve te tenderit, operatori nuk ka paraqitur kontrate qeraje te vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates. Në kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2 kapaciteti teknik kerkohet disponimi i nje mjeti transporti i tipit kamion ne pronesi ose me qera. Kur eshte me qera per mjetin duhet te paraqitet:

1. Kontrata e qerase (*e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates*)
2. Certifikata e pronesise
3. Leja e qarkullimit
4. Certifikata e kontrollit teknik
5. Siguracioni i mjetit

Kontrata e qerase e lidhur me Dritan Selamaj ne cilesine e qiradhenesit, per mjetin e transportit kamion me targe AA 283 JU eshte lidhur ne daten 04.08.2016 me afat 3 vjecar dhe perfundon ne daten 04.08.2019, periudhe e cila nuk mbulon te gjithë afatin e realizimit te kontrates, objekt i prokurimit.

3. Shoqeria “S I R E T A 2F” SH.P.K, per arsye se:

Operatori nuk ka paraqitur dokumentacion per plotesimin e kriterëve te vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 ne te cilin kerkohen:

Furnizime të ngjashme me vlere 40% te fondit limit të realizuara gjatë tre viteve të fundit .

Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me ente publike duhet te paraqitet kontrata shoqeruar me vertetimin per realizimin e sukseshem te kontrates ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Ne rast te pervojës te meparshme te realizuar me sektorin privat duhet te paraqiten fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

4. Shoqeria “RESULI - ER” SH., per arsye se:

Nuk eshte paraqitur oferte ekonomike.

Nuk jane paraqitur shtojcat e dokumenteve te tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “SIMAKU SHPK” SH.P.K, NIPT K43721001Q DHE “VASHTEMLIA” , NIPT J64103054Q,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **21,825,000 (njezet e nje milion e teteqind e njezet e pese mije) leke pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Ndermarrjes se Sherbimeve Publike, Bashkise Korçë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kërkesa per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 18.03.2019

Ankesa: **Nuk ka**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI**

